



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 5122/6 Prot.

Pogradec, më 20.12 .2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim

Znj. Manjola KAMOLLI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj. Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues: “Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës “Myredin Bashalli”, Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec”.

Konceptoi: L.SHKULLAKU
Pranoi: M.ÇUNI
Miratoi: A.KANINA

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



Datë:

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2023

PROJEKT-VENDIM

NR _____, DATË _____.____.2023

PËR

“PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBIENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, TË CILAT DO TË SHËRBEJNË SI KOPËSHT DHE SHKOLLË PËR ARSIMIN 9-VJECAR, DERI NË PËRFUNDIM TË PLOTË TË RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS “MYREDIN BASHALLI”, LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC”

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 11 dhe 12 të nenit 23, shkronjës "k", të nenit 54, "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak" të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 28 të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjës "a", të nenit 7 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe mbështetur tek Relacioni shpjegues i Qendrës Arsimore, pranë Bashkisë Pogradec,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**

1. Të miratojë, normat, kriteret, rregullat dhe procedurën për marrje ambienti dhe objekti me qira, për të shërbyer si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjeçar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, të ndodhur në juridiksionin territorial të Bashkisë Pogradec, si më poshtë:



1.1 Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.

1.2 Fshati Piskupat, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.

2. Ambienti i marrë me qira, të jetë i përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë “Kopësht publik”, dhe “Shkollë publike”, dhe të jetë në Njësinë Administrative Udënisht.
3. Vlera e qirasë mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurrimit të përcaktohet pas testimit të vlerës së tregut, por jo më shumë se vlerat e poshtë shënuara:

3.1 Në të dyja fshatrat Lin dhe Piskupat, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec, qiraja mujore të mos e kalojë vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lek në muaj.

4. Procedura e konkurrimit për marrjen e objektit me qira, t’i nënshtrohet hapave si më poshtë:

4.1 Struktura e posaçme e krijuar me urdhër të kryetarit të bashkisë Pogradec, të hartojë dhe të publikojë njoftimin për zhvillimin e procedurës së konkurrimit në buletin e publikimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në këndin e publikimeve pranë Bashkisë Pogradec.

4.2 Afati i paraqitjes së ofertave të zgjasë të paktën 7 (shtatë) ditë që nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së.

4.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e hapjes së procedurës konkurruese, të shqyrtojë ofertat e kualifikuara si të rregullta dhe të vlerësojë me çmim më të ulët ofertën/ofertat, dhe të hartojë vendimin për renditjen e ofertuesve.

4.4 Subjekteve pjesëmarrëse në konkurrim, t’iu njihet e drejta e ankimit me shkirm, pranë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

4.5 Në përfundim të hapave të mësipërme, të autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, për nënshkrimin e kontratës së qirasë.

5. Kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë deri në përfundimin e vitit shkollor 2023-2024.

6. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

7. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2023

RELACION

“PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBIENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, TË CILAT DO TË SHËRBEJNË SI KOPËSHT DHE SHKOLLË PËR ARSIMIN 9-VJECAR, DERI NË PËRFUNDIM TË PLOTË TË RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS “MYREDIN BASHALLI”, LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC ”

I/e nderuar Kryetar i Këshillit!

Të nderuar këshilltarë!

Në shkollën 9-vjeçare “Myredin Bashalli”, e ndodhur në fshatin Lin, Njësia Administrative Udënisht sapo ka nisur rikonstrukcioni i kësaj godine dhe për këtë arsyë duhet të merren masa urgjente në mënyrë që nxënësit të akomodohen në një ambient tjetër dhe procesi mësimor të mos nderpritet për asnjë moment.

Duke patur parasysh se nga ana e drejtuesit të shkollës dhe Administratorit të Njesisë Administrative Udënisht, na është bërë i ditur ky problem ,për të mos nderprerë procesin mësimor, kemi menduar si të vetmen alternativë për një zgjidhje të përkohshme që përveç përshtatjes së ambienteve aktuale të kopshteve (Boqezë dhe Piskupat) në klasa shkollore, të merren me qira dy ambiente private duke siguruar kështu vazhdimësinë e këtij procesi. Pas testimit të tregut të kryer nga ana e grupit të punës, në Njësinë Administrative Udënisht ka rezultuar se çmimet më të përshtatshme krahasuar me gjendjen dhe madhësinë e godinës të jenë në fshatin Piskupat me vlerë 15.000 lekë në muaj ku do të krijohen 3 klasa dhe do të zhvillojnë mësimin rreth 30 fëmijë si edhe në fshatin Lin me vlerë po të njëjtë 15.000 lekë në muaj ku do të krijohen 3 klasa dhe do të zhvillojnë mësimin rreth 36 fëmijë. Gjithashtu një ambient na është ofruar pa qera nga një banor i fshatit Lin, për të cilin do të paguajmë vetëm shpenzimet mujore ,energji elektrike dhe ujë.

Ne këto kushte Bashkia Pogradec, për të patur mbrojtje dhe garantim të interesit publik, në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 11 dhe 12 të nenit 23, shkronjës “k”, të nenit 54, “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” të Ligjit Nr.139, datë



17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 28 të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjës "a", të nenit 7 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", kërkon nga ana juaj për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.

Ju Faleminderit!

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Alma Kanina

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI